

KONTRATË SHITJE AKSIONESH

Sot më datë 24/06/2024, në Tiranë, palët e mëposhtme vendosën të lidhin kontratën e shitjes së aksioneve si më poshtë:

SHITËSI: **Z. Arjan HANA**, lindur më 11.06.1979, në Tiranë, shtetas Shqiptar, me adresë Rruga "Hiqmet Buzi", Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal: H90611123S, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar (në cilësinë e **Shitësit**).

DHE

BLERËSI: **Shoqëria "TEOREN" shpk**, person juridik i të drejtës shqiptare, me NIPT K51407506E, me seli në adresën Durrës, Borake, km 15, në krah të Autostradës Durrës - Tiranë, përfaqësuar nga administratori **Orest Çelo**, i datëlindjes 16.09.1983 identifikuar me letërnjoftimin ID me numër personal I30916008C (në cilësinë e **Blerësit**).

OBJEKTI: Shitja e 109,951 (njëqind e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) aksioneve të "BANKA CREDINS" sh.a, që zotërohen nga aksioneri **Z. Arjan HANA** dhe blerja e tyre nga shoqëria "TEOREN" shpk.

PËRMBAJTJA E KONTRATËS


Shoqëria "BANKA CREDINS" sh.a., është një shoqëri anonime e krijuar e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 28969, datë 31.01.2003, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal NR. 3709529, NIPT K31608801O, si dhe me licencën nr. 16, datë 31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE DHE MËNYRA E PAGESËS

Palët kanë rënë dakord 109,951 (njëqind e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) aksione të shiten me një çmim 1.819 Euro/aksion, me çmimin total prej 200,000.87 (dyqind mijë pikë tetëdhjetë e shtatë) Euro.

Pagesa në shumën e mësipërme do të kryhet në rrugë bankare dhe do të derdhet në llogarinë e Shitësit pranë Bankës Credins me nënshkrimin e kontratës.

MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE



Shitësi është plotësisht dakord dhe i shet me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë Blerësit 109,951 (njëqind e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) aksione të shoqërisë "BANKA CREDINS" sh.a, që ai zotëron në kapitalin aksionar të Bankës.

Kalimi i pronësisë do të bëhet me pagesën e plotë të shumës 200,000.87 (dyqind mijë pikë tetëdhjetë e shtatë) Euro nga ana e Blerësit shoqërisë "TEOREN" shpk, në llogarinë e Shitësit Z. Arjan HANA.

KLAUZOLAT PËR TË DREJTAT MBI DIVIDENTIN DHE TË TJERA

Aksionet objekt kontrate kalojnë dhe transferohen tek Blerësi së bashku me të gjitha të drejtat që shoqërojnë dhe lidhen me aksionet, përfshirë çdo lloj dividendi, rritje kapitali, e drejta e votës, dhe në përgjithësi çdo lloj e drejte tjetër e papërmendur, por që njihet nga statuti dhe ligji. Përfitimi i këtyre të drejtave bëhet së bashku me transferimin e pronësisë mbi aksionet nga Shitësi tek Blerësi me pagesën e çmimit të shitjes së aksioneve.

LIGJI I ZBATUESHËM

Palët bien dakord që kjo Kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për çfarë nuk parashikohet në këtë Kontratë aplikohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi shitjen.

TË TJERA

Kontrata hartohet në 4 kopje origjinale, duke patur të gjitha vlerë të njëjtë, nënshkruhet prej palëve me dëshirë dhe vullnetin e tyre të plotë e të pavesuar.

SHITËSI

Arjan HANA

Arjan Hana



BLERËSI

Shoqëria TEOREN shpk

Përfaqësuar nga

Administratori

Orest ÇELO

